



INSTITUTI I KURRIKULËS DHE TRAJNIMIT

PROGRAMET E KURRIKULËS ME ZGJEDHJE TË GJIMNAZIT

FUSHA: SHKENCA NATYRORE

MODULI: NJERIU DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE

KODI: 7.01

**PROGRAMI I MODULIT
“NJERIU DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE”**

PËR KLASËN E 10

TIRANË, SHTATOR 2008

Moduli "Njeriu dhe ndryshimet klimatike", për klasën e dhjetë të gjimnazit, fokusohet në kompleksitetin e ndryshimeve klimatike duke i dhënë nxënësve mjetet dhe background-in e nevojshëm për të kuptuar këto ndryshime dhe ndikimin e tyre në mjedis e shoqëri. Problemet aktuale mjedisore dhe ato që parashikohen për të ardhmen kanë filluar të tërheqin çdo ditë e më shumë vëmendjen e medias, të niveleve qeveritare, të grupimeve qytetare si dhe shqetësimin e shumë individëve në lidhje me pasojat për njerëzimin dhe jetën e gjallë në Tokë. Këto probleme janë lokale, rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Për të bërë zgjidhje sa më të qëndrueshme mjedisore në lidhje me problemet e shumta mjedisore me të cilat po ndeshemi, duhet të bëjmë zgjedhje, të marrim vendime, bazuar mbi ekzaminime kritike të informacionit dhe opinioneve.

Marrja nga nxënësit e informacionit mbi ndryshimet klimatike është e nevojshme sepse njeriu është faktori qendror i mjaft problemeve mjedisore globale, si shkak i të cilave shpesh qëndron niveli i pamjaftueshëm i njohurive për procese të ndryshme në natyrë e mjedis dhe për rrjedhojë një sjellje e papërgjegjeshme ndaj zgjidhjes së këtyre problemeve. Vetëdija dhe ndërgjegjësimi janë pikënisje për zgjidhje dhe një sërë problemesh mjedisore lokale por dhe globale. Zhvillimi i një moduli që trajton problemet që lidhen me ndryshimet klimatike do ta bëjë nxënësin të ndjehet pjesë e pandashme e planetit dhe problemeve të tij, si dhe të kuptojë e të veprojë me moton "*Mendo globalisht, vepro lokalisht*".

Përmbajtja e këtij moduli nuk përbën vetëm një vëllim njohurish, por u siguron nxënësve rrugë të njohjes, përmes vëzhgimeve, analizave të të dhënave statistikore, hulumtimeve, punëve në grupe, projekteve, etj., për pasojë zhvillimin tek nxënësit të një sërë aftësish si të menduarit problemzgjidhës, krijues dhe kritik, aftësitë për të bashkëpunuar, për të debatuar, për të komunikuar, etj. Duke kaluar në linjat kryesore të këtij moduli, si dhe përmes projekteve, detyrave tematike që lidhen me këto linja, nxënësi do të mund të kuptojë rëndësinë që ka mënyra e tij e jetesës për një mjedis të shëndetshëm.

Nëpërmjet këtij moduli nxënësit do të nxiten për të menduar dhe reflektuar sistematikisht, në mënyrë kritike dhe krijuese si për çështjet lokale dhe ato globale, të cilat përbëjnë dhe kushtet paraprake për një zhvillim të qëndrueshëm të shoqërisë.

Moduli "Ndryshimet klimatike" për klasën e dhjetë të gjimnazit do të zhvillohet në 36 orë mësimore në vit, që do të thotë me 1 orë mësimore në javë.

1. SYNIMI I MODULIT

Programi i modulit "Ndryshimet klimatike" synon:

T'u japë nxënësve njohuritë dhe t'i pajisë me aftësitë e domosdoshme për të kuptuar, analizuar dhe vlerësuar ndryshimet e sotme klimatike, pasojat që lidhen me to si dhe politikat për menaxhimin e tyre, për t'i bërë nxënësit pjesë të mbrojtjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm të planetit ku jetojmë.

2. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Në përfundim të këtij programi, nxënës/i, -ja duhet të jetë i/e aftë :

- të kuptojë ndikimin e ndryshimeve klimatike në sistemet natyrore dhe në jetën e njeriut e anasjelltas;
- të vlerësojë perspektivat për menaxhimin e ardhshëm të ndryshimeve klimatike;
- të demonstrojë aftësi për të vlerësuar zgjidhjet alternative dhe implikimet e tyre mjedisore;
- të analizojë marrëdhënien ndërmjet burimeve, teknologjisë dhe mjedisit;
- të demonstrojë aftësitë e komunikimit, menaxhimit të informacionit, problemzgjdhjes, të menduarit kritik dhe krijues;
- të përdorë informacionin dhe teknologjitë e komunikimit në mbështetje të studimeve të tij;
- të demonstrojë qëndrime etiko-sociale gjatë punës në grup dhe si individ;
- të zhvillojë aftësitë e pjesëmarrjes qytetare në debate.

KLASA 10

36 javë x 1 orë në javë = 36 orë

3. OBJEKTIVA TË LINJAVE

Linja: Ndërveprimi i njeriut me mjedisin

Përshkrimi i linjës: Nxënës/i,-ja analizon marrëdhënien ndërmjet njeriut dhe mjedisit si dhe përpiqet t'u japë përgjigje pyetjeve: A kanë ekzistuar më parë ndryshimet e klimës? Është hera e parë që planeti përballet me ndryshime të tilla? Cilët janë skenarët që shkenca sjell sot në shpjegim të këtij fenomeni, i cili po sjell ndryshime kaq të mëdha e të shpejta për jetën në planet? A është njeriu faktori kryesor i ndryshimit të klimës?

Pasojat e ndryshimeve klimatike sot janë të prekshme nga të gjithë. Ndjeshmëria ndaj ndryshimeve klimatike është rritur dukshëm sidomos në nivelet e larta të qeverisjes dhe bashkëpunimet ndërshtetërore. Shumë konsiderata të ndryshme në lidhje me ndryshimet klimatike janë përfshirë në programe, traktate dhe marrëveshje ndërkombëtare siç janë konventat.

Orët e sugjeruara¹: 26 orë

Bloku tematik	Objektiva të linjës
---------------	---------------------

¹ Orë të sugjeruara janë orët e planifikuara për zhvillimin e linjës. Shuma totale e orëve të linjave duhet të jetë sa numri i plotë i orëve në planin mësimor për këtë lëndë. Quhen të sugjeruara sepse i jepet liri zbatuesit të programit (mësuesit) që të shtojë ose pakësojë numrin e sugjeruar të orëve në masën 10% sipas nevojave të klasës.

<p style="text-align: center;">Efekti serë dhe shkarkimet e gazeve serë</p>	<p style="text-align: center;">Në përfundim të klasës së 10-të, nxënës/i, -ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajë dukurinë e efektit serë si proces natyror vetërregullues dhe domosdoshmërinë e tij për jetën në Tokë; • të identifikojë gazet serë dhe burimet kryesore të shkarkimit të tyre; • të gjejë shembuj nga mjedisi ku jeton në lidhje me shkarkimin e gazeve serë; • të diskutojë në lidhje me shkarkimet e dioksidit të karbonit nga sektori i prodhimit të energjisë; • të kuptojë lidhjen që ekziston midis burimeve të ripërtëritëshme të energjisë dhe zvogëlimit të gazeve serë në mjedis; • të përgatisë një raport mbi rritjen e përqëndrimit të gazeve serë në atmosferë si pasojë e aktivitetit të njeriut në nivel lokal apo global, bazuar në të dhënat e siguruara përmes literaturës, vëzhgimeve, Internetit, informacioneve nga institucione apo organizata mjedisore; • të skicojë një poster apo fletë palosje në lidhje me ndotjen e ajrit (me pasoja lokale) dhe ndryshimet klimatike (me pasoja globale).
<p style="text-align: center;">Ndryshimet klimatike “mit” apo realitet</p>	<ul style="list-style-type: none"> • të analizojë ndryshimet klimatike bazuar në fakte dhe të dhëna konkrete; • të sjellë shembuj historikë të ndryshimeve klimatike; • të përshkruajë rolin e paleoklimatologjisë në studimin e klimës përgjatë kohërave; • të dallojë ndryshimet midis skenarëve të ndryshëm që shpjegojnë fenomenin e ndryshimeve të klimës; • të debatojë përmes argumentave pro ose kundër mbi opsionin se ”Klima në Tokë ndryshon në mënyrë të natyrshme dhe ndryshimet e kohëve të fundit (nuk) janë pasojë e aktivitetit njerëzor”; • të shpjegojë pse ndryshimet klimatike janë sfidë për shoqërinë e zhvillimin e saj sot; • të realizojë individualisht ose në grup një projekt të historisë gojore përmes të cilit nxënësit intervistojnë banorë të vjetër në komunitet rreth ndryshimeve klimatike gjatë jetës së tyre.

**Pasojat e
ndryshimeve
klimatike në mjedis
dhe në shëndet**

- të përshkruajë tiparet kryesore që shoqërojnë ndryshimet klimatike duke përdorur shembuj nga jeta e gjallë e Planetit;
- të dallojë pasojat negative të ngrohjes së klimës;
- të listojë strategji të cilat mundësojnë përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike (të tilla si zhvillimi i teknologjisë për përdorimin e burimeve, përmirësim të legjislacionit, etj);
- të bëjë kërkime në lidhje me faktin se sa sektori i bujqësisë ndikon në ndryshimin e klimës dhe anasjelltas;
- të argumentojë marrëdhënien që ekziston midis ndryshimeve klimatike dhe sigurisë ushqimore;
- të diskutojë mbi faktin që shkrirja e akujve do të sjellë zhvendosjen e popullatave që jetojnë në ishuj apo zona bregdetare;
- të mbledhë të dhëna mbi rritjen e nivelit të oqeaneve e deteve, rajonet më të rrezikuara nga përmbytjet në nivel rajonal e global, ndikimin e rritjes së nivelit të deteve e oqeaneve në sektorët e ekonomisë (si, p.sh. turizmi, ndërtimet urbane, peshkimi etj);
- të shpjegojë lidhjen ndërmjet biodiversitetit dhe ndryshimeve klimatike;
- të debatojë në lidhje me ndryshimet që mund të pësojnë brezat bio-gjeografikë me ngrohjen e motit;
- të përgatisë një detyrë tematike argumentuese pse bimët dhe kafshët e kanë më të vështirë t'iu përshtaten ndryshimeve klimatike;
- të identifikojë mbi bazën e analizave krahasuese gjallesat më të rrezikuara nga ngrohja e motit (ato që jetojnë në dete apo ato që jetojnë në zona malore);
- të kryejë vëzhgime në zonën ku jeton mbi bimët apo kafshët e kërcënuara nga ndryshimet klimatike;
- të sjellë fakte që tregojnë që mbjellja e pemëve ndihmon në zbutjen e pasojave negative që kanë ndryshimet klimatike;
- të përshkruajë ndikimet e ndryshimeve klimatike mbi ekosistemet detare dhe bregdetare;
- të shpjegojë marrëdhënien burime ujore/ndryshime klimatike;
- të realizojë individualisht ose në grup intervista, biseda me specialistë të shëndetit e mjedisit mbi rreziqet me të cilat ekspozohet shëndeti i njeriut sot si pasojë e ndryshimeve klimatike;

	<ul style="list-style-type: none"> • të kërkojë në burime të ndryshme informacioni si internet, botime, enciklopedi, fakte që vërtetojnë përhapjen e sëmundjeve ngjitëse si pasojë e ngrohjes së motit; • të analizojë lidhjen që ekziston midis fenomeneve ekstreme të motit si stuhive, përmytjeve, tajfuneve dhe ndryshimeve të klimës; • të sjellë shembuj të intensifikimit të përmytjeve, cikloneve tropikale, etj, në rajone të ndryshme; • të vlerësojë rolin e njeriut në përmirësimin e pasojave negative të ndryshimeve klimatike; • të realizojë në grup projektin “Klima në qytetin tim” ku përmes vëzhgimeve, intervistave, bisedave, materialeve, etj., mbledh informacion dhe diskuton mbi pasojat e ndryshimeve klimatike në jetën e qytetarëve; • të shpjegojë me argumenta logjike pse përdorimi i bicikletës, ecja në këmbë apo përdorimi i transportit publik janë mënyra miqësore me mjedisin dhe nuk ushtrojnë presion mbi ndryshimet klimatike; • të përgatisë një plan aktiviteteve për nxënësit e shkollës, klasës së tij, të cilat do të ndikojnë sado pak në lehtësimin e pasojave negative të ndryshimeve klimatike.
<p style="text-align: center;">Legjislacioni në lidhje me ndryshimet klimatike (konventat dhe legjislacioni shqiptar)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajë disa ndër aspektet e përgjithshme të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike; • të tregojë disa prej ligjeve shqiptare që lidhen me shkarkimet e gazeve serë në Republikën e Shqipërisë; • të debatohet mbi detyrimet që parashtron Protokollin e Kiotos për vendet anëtare; • të diskutojë duke parashtruar argumenta pse disa vende të zhvilluara nuk nënshkruajnë Protokollin e Kiotos; • të vlerësojë rëndësinë e formulimit të strategjive dhe zbatimin e tyre në zvogëlimin e shkarkimeve që lidhen direkt me gazet serë; • të përgatisë një prezantim me shkrim ose me gojë mbi veprimet që duhet të ndërmerret Shqipëria, si vend anëtar i konventës, për rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit mbi ndryshimet klimatike; • të përgatisë një detyrë tematike mbi detyrimet që dalin nga zbatimi i legjislacionit shqiptar në lidhje me ndryshimet klimatike për publikun dhe vetë nxënësit.

Linja: Përgjegjësitë personale dhe qytetare

Përshkrim i linjës: Është mjaft e lehtë që "faji" për çlirimin në atmosferë të dioksidit të karbonit t'u vihet makinave dhe industrisë, për faktin se i shohim të çlirojnë këtë gaz ndotës çdo ditë. Megjithatë, duhet pranuar se edhe aktiviteti ynë i përditshëm është faktor që kontribuon në çlirimin e dioksidit të karbonit në atmosferë.

Edukimi dhe rritja e ndërgjegjësimit mbi ndryshimet klimatike janë hapa të rëndësishëm drejt përmirësimit të efikasitetit të përdorimit të energjisë dhe minimizimit të çlirimit të gazeve serë në atmosferë. Unë, ti dhe çdokush duhet ta kuptojë dhe të veprojë nën moton "Mendo globalisht, vepro lokalisht". Izolimi termik në banesa, përdorimi i llambave efikente për ndriçim, përdorimi i energjisë diellore për ngrohjen e ujit, në dukje janë procese që nuk lidhen shumë me ndryshimet e klimës, por në fakt ato ndihmojnë shumë në kapërcimin e kësaj sfide.

Orët e sugjeruara: 10 orë

Bloku tematik	Objektiva të linjës
Unë përballë ndryshimeve klimatike	<p>Në përfundim të klasës së 10-të, nxënës/i, -ja:</p> <ul style="list-style-type: none">• të zbatojë parimet bazë për një jetë miqësore me mjedisin;• të argumentojë pse sjellja si konsumatorë promjedisorë mund të zvogëlojë prodhimin e gazeve serë;• të evidentojë etiketimet apo simbolikat e produkteve efikente, të cilat shpenzojnë pak energji, kursejnë para dhe ndihmojnë në mbrojtjen e mjedisit;• të sjellë shembuj etiketimesh nga jeta e përditshme që lidhen direkt me mbrojtjen e mjedisit, siç mund të jenë ato të produkteve miqësore me ozonin, pa kimikate të rrezikshme, ricikluese, etj.• të përgatisë një plan veprimi në lidhje me përdorimin e automjeteve dhe zvogëlimin e ndotjes në ajër, në mënyrë të veçantë reduktimin e gazeve të dioksidit të karbonit;• të bëjë një lidhje logjike midis, kursimit, ripërdorimit dhe riciklimit si parime bazë që shërbejnë për minimizimin e mbetjeve dhe ndryshimeve klimatike;• të identifikojë disa aktivitete industriale që janë përgjegjëse për ndryshimet e klimës;• të realizojë në grup një projekt që nxit riciklimin e letrës, kartonit për shkollën e tij duke e lidhur atë me zvogëlimin e çlirimit të dioksidit të karbonit në

	<p>atmosferë;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përgatisë ese me temë “Përdorimi i transportit publik ndihmon mjedisin” apo “Biçikleta - makina më efiçente që është prodhuar ndonjëherë”; • të argumentojë pse përdorimi i burimeve alternative të energjisë, si ajo diellore, e erës, gjeotermale dhe e hidroenergjisë, ndihmon në zvogëlimin e efekteve negative të ndryshimeve klimatike; • të vlerësojë rëndësinë jetësore të mbrojtjes së pyjeve dhe mbjelljes së pemëve; • të përgatisë një detyrë tematike “Ndryshimi i klimës është veçse një vdekje e ngadaltë për planetin tonë”; • të krijojë p.sh.: një album apo CD, video, me foto të bëra vetë apo të mblledhura nga burime të tjera, komente që flasin për ndryshimet klimatike dhe ndikimin e veprimtarisë së njeriut.
--	---

4. KËRKESAT E MODULIT ”NJERIU DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE” NDAJ KURRIKULËS BËRTHAMË

Ndryshimet klimatike	Shkenca e Tokës
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Për të gjitha linjat 	<p>Nxënës/i, -ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të përdorë konceptet klimë, faktorët kryesorë që ndikojnë në klimë, rajonet klimatike.
Ndryshimet klimatike	Matematika
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Shpërndarja e sasisë së reshjeve. ▪ Shpërndarja shumëvjeçare e temperaturave minimale dhe maksimale. 	<p>Nxënës/i, -ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të ndërtojë një grafik ose diagramë me shtylla në planin koordinativ me dy variabla p.sh., për të interpretuar shpërndarjen vjetore të sasisë së reshjeve apo temperaturave.
Ndryshimet klimatike	TIK
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Për të gjitha linjat 	<p>Nxënës/i, -ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të përdorë ëord-processor në shkrimin e materialeve dhe punëve praktike. ▪ të përdorë PoëerPoint për prezantimin e një raportit, materiali informues, projekti kërkimor.

Ndryshimet klimatike	Biologjia
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Diversiteti biologjik dhe ekosistemet ▪ Shëndeti 	<p>Nxënës/i, -ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të përdorë konceptet ekosistem, habitat, popullatë, lloj, biodiversitet, biomasë. ▪ të përdorë termat virus, bakter, antitropa, virozë.
Ndryshimet klimatike	Gjuha shqipe dhe letërsia
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Për të gjitha nënlinjat 	<p>Nxënës/i, -ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shkruajë ese përshkruese dhe argumentuese për tematika të veçanta të modulit (p.sh., përdorimi i transportit publik ndihmon mjedisin).

5. KËRKESA PËR ZBATIMIN E MODULIT

Ky modul, "Njeriu dhe ndryshimet klimatike", zbatohet për 36 orë mësimore vjetore. Programi i tij është një dokument zyrtar, pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtare. Hartimi i programit është mbështetur, si te korniza kurrikulare ashtu edhe te standardet e fushës.

Për të siguruar përdorimin sa më të mirë të programit është e vlefshme njohja me dokumentet e lartpërmenduar.

Tek korniza kurrikulare vëmendje e veçantë i duhet kushtuar:

- Synimeve të përgjithshme të kurrikulës së gjimnazit,
- Synimeve të linjave ndër-kurrikulare,
- Vlerësimin të nxënësit me notë,
- Parimeve të mësimdhënie-mësimnxënies.

Në mënyrë që programi i këtij moduli të zbatohet sa më mirë, përdoruesit e tyre duhet të njohin thellë programin lëndor të lëndës së Shkencës së Tokës për klasën e dhjetë të gjimnazit (kurrikula bërthamë).

Gjithashtu, zbatuesve të këtij moduli u lind nevoja të njohin standardet e të gjitha fushave të tjera të të nxënësit dhe të gjitha programet lëndore të të njëjtit vit.

Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore, fetare.

Objektivat

Objektivat e programit janë për të gjithë nxënësit që zgjedhin të studiojnë këtë modul dhe janë detyrim për përdoruesit e programit. Kjo do të thotë se që të gjithë nxënësve që përzgjedhin këtë modul, duhet t'u jepet mundësia që të nxënë ç'ka përshkruhet tek objektivat. Realizimi i objektivave në tema, kapituj, njësi dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të programit.

P.sh., objektivi: “të analizojë ndryshimet klimatike bazuar në fakte dhe të dhëna konkrete” kërkon që të gjithë nxënësve t’u jepet mundësia që bazuar në faktë dhe të dhëna, të analizojnë ndryshimet klimatike. Nëse një mësues nuk e bën këtë, nuk ka zbatuar programin e këtij moduli.

Orët mësimore

Programi i modulit "Njeriu dhe ndryshimet klimatike", për klasën e dhjetë, është strukturuar në linja që vijnë njëra pas tjetrës, por nuk do të thotë se mësimdhënia-mësimnxënia duhet të zhvillohet domosdoshmërisht në këtë renditje gjatë vitit shkollor.

Sasia e orëve mësimore për secilën linjë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën linjë. Domethënë, mësuesi mund të vendosë të përparojë më ngadalë kur vë re se nxënësit e tij hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektivave, por mund të ecë më shpejt kur nxënësit e tij demonstrojnë një përvetësim të kënaqshëm.

Programi i modulit "Njeriu dhe ndryshimet klimatike" realizohet në **36 orë mësimore vjetore**, prej të cilave afërsisht **60%** e orëve mësimore totale janë për shtjellimin e **njohurive të reja lëndore** dhe **40%** e tyre janë për **përpunimin e njohurive** (gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor).

Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përmban:

- Vëzhgimet në terren;
- Përsëritjen brenda një kapitulli të njohurive-bazë të tij (konceptet themelore);
- Testimin e njohurive-bazë;
- Integrimin e njohurive të reja të një kapitulli me njohuritë e kapitujve paraardhës;
- Integrimin e njohurive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (Ndonëse këto integrame do të përshkojnë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit i duhet kushtuar kohë e posaçme);
- Përsëritjen vjetore (Pavarësisht nga ndarja në linja ose në kapituj, lënda duhet parë si një e tërë);
- Testimin vjetor (nuk është i detyruar).

Veçanërisht gjatë përpunimit të njohurive duhet t’i kushtohet kohë e posaçme kultivimit të:

- Aftësive të përgjithshme si e komunikimit, e menaxhimit të informacionit, e zgjidhjeve problemore, e të menduarit kritik dhe krijues;
- Aftësive të posaçme lëndore si vëzhgimet e drejtpërdrejta në terren, projektet kurrikulare;
- Formimit të qëndrimeve, si qëndrimi etiko-social dhe gjatë punës në grupe të vogla nxënësish..

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive, nxënësve duhet t’u krijohet mundësia të punojnë detyra tematike (si p.sh. të përgatisë një detyrë tematike mbi detyrimet që dalin nga zbatimi i legjislacionit shqiptar në lidhje me ndryshimet klimatike për publikun dhe vetë nxënësit); projekte kurrikulare (si p.sh. të realizojë individualisht ose në grup një

projekt të historisë gojore përmes të cilit nxënësit intervistojnë banorë të vjetër në komunitet rreth ndryshimeve klimatike gjatë jetës së tyre).

Objektivat që kanë të bëjnë me mbledhjen e informacionit me anë të teknologjive të komunikimit dhe informimit, nuk kanë për qëllim vetëm mbledhjen dhe renditjen e informacionit të kërkuar, por ndërveprimin aktiv të nxënësit me këto teknologji në procesin e të nxënësve.

Kujdes i veçantë duhet treguar në realizimin e objektivave që kanë të bëjnë me zhvillimin e aftësive intelektuale dhe sociale të nxënësve, si ato të debatimit, diskutimit, punës në grup etj.

Pjesë e përpunimit të njohurive është rishqyrtimi vjetor i cili ka për qëllim të nxjerrë në pah dhe përforcuar konceptet e metodat themelore të këtij moduli.

6. VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat programin lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program.

Objektiv i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etiko-sociale në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti.

Mësuesi zhvillon vetë e ndihmon nxënësit të zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi. Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënësi vlerësohet me notë ndërsa demonstroi arritjet e tij me gojë, me shkrim, ose nëpërmjet veprimtarish e produktesh të tjera, si: realizon një projekt kurrikular, një detyrë tematike etj.

Në punime të nxënësve me grupe të vogla, mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënësi në veçanti.

Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe të vendosë nota në regjistër për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet lirshëm të bashkëbisedojnë si partnerë rreth përvetësimit të njohurive të fituara të orëve të kaluara dhe mirëkryerjes së detyrave jashtë klase.

Herë pas here, mësuesi duhet të vlerësojë me notë duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër por edhe në rrugë elektronike. Mësuesi vlerëson nxënësin me notë për parashtrimet me shkrim në provimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij, të zhvilluara vetë ose në grup.

Mësuesi planifikon provime periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore që përbëhen nga një a disa kapituj, të cilët i bashkojnë objektiva të ndërlydhura të të nxënësve. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai përdor lloje të ndryshme testesh, që nga minitestet pakminutëshe për një objektiva të veçuar të të nxënësve, tek ato një orëshe; teste me alternativa ose zhvillim, detyra tematike, projekte kurrikulare etj. Zbatuesit e programit duhet të kenë parasysh se vlerësimi i nxënësve në këtë modul vetëm me teste është i pjesëshëm dhe nuk jep informacion të plotë mbi atë se çfarë di dhe

çfarë është në gjendje të bëjë nxënësi. Testet tradicionale, si ato me zgjedhje të shumëfishtë apo me përgjigje të shkurtër në fund të një blloku tematik ose kapitulli, nuk vlerësojnë dot se sa di nxënës/i,-ja të bëjë vrojtime dhe matje të sakta, të analizojë të dhënat dhe të nxjerrë përfundime.

Një formë e parashtrimit me shkrim nga nxënësit është dhe provimi përfundimtar.

Portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor për një lëndë të caktuar. Ai mund të përmbajë provime me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, intervista me anëtarë të familjes apo anëtarë të tjerë të komunitetit për tematika të ndryshme mjedisore, pyetësorë, ese përshkruese ose argumentuese për një problem të caktuar mjedisor, madje dhe fotografi të veprimtarive të realizuara.. Punët e nxënësve që janë pjesë e portofolit përzgjidhen nga nxënësit, mësuesi, apo me këshillimin e njëri-tjetrit.

Çrregullime të diagnostikuara si: disleksia, vështirësi të veçanta gjuhësore, p.sh., të fëmijëve të ardhur rishtaz nga emigracioni, merren parasysh nga mësuesi duke u mundësuar këtyre nxënësve të vlerësohen me mënyra të posaçme, duke përjashtuar atë me shkrim apo me gojë.